

**Njoftim i përqendrimit me të cilin Nestle Bulgaria SHA., Bullgari do të fitoj kontrollin mbi ISO-PLUS  
BG EOOD., Bullgari**

**(lënda nr. 08-17/2023)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 13.01.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim i përqendrimit me të cilin Nestle Bulgaria SHA, me seli në Bul. Evropa nr. 128, 1360 Sofje, Bullgari mbi ISO-PLUS BG EOOD, me seli në Gjueshevë nr. 83, 1379 p.k. Serdika, Sofje, Bullgari.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:**

Nestle Bulgaria SHA është një shoqëri aksionare bullgare (Société Anonyme), anëtare e grupit zviceran të kompanive Nestle. Nestle Bulgaria SHA është e përfshirë kryesisht në prodhimin dhe shpërndarjen e pijeve pluhur dhe të lëngshme, produkte për kujdesin e kafshëve shtëpiake, ushqime të gatshme dhe mjete ndihmëse për gatim, ëmbëlsira, produkte qumështi, produkte ushqimore të shëndetshme dhe drithëra. Ndër produktet që i përkasin Nestle Group janë vitaminat, mineralet dhe suplementet ushqimore të shitura nën markën "Solgar".

Grupi Nestle ka një ndërmarrje-bijë të themeluar në Maqedoninë e Veriut, shoqërinë Nestle Adriatik Makedonia shpknjp Shkup, me seli në Bulevardin "8-të Shtatori" nr. 16, Faksi 663, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, nr. amzë 6103820, aktive në shitjen e kategorive të ndryshme të produkteve Nestle.

**ISO-PLUS BG EOOD** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar nga një person, e themeluar siç duhet dhe vepron sipas ligjeve të Bullgarisë, e angazhuar në shpërndarjen e produkteve Solgar kryesisht në Bullgari.

ISO-PLUS BG EOOD ka themeluar një filial në Maqedoninë e Veriut, - ISO-PLUS BG EOOD, R. Bullgari - Filial Shkup, me seli Bulevardin Partizanski Odredi 63/1-2, Shkup, EMBS 7140754, aktive vetëm në shitjen e produkteve të markës Solgar.

Sipas parashtruesit të njoftimit tregu relevant të cilit i referohet përqendrimi i tregut të prodhimit të vitaminave, mineraleve, suplementeve ushqimore.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

20.01.2023

Shkup